



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 206, Datë 27.06.2023

MBI

**NJOHJEN E LICENCËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË FURNIZIMIT  
DHE TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË NGA KOMISIONI  
RREGULLATOR I ENERGJISË DHE SHËRBIMEVE TË UJIT I REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË SË VERIUT, PËR SUBJEKTIN “SOLE 24 IMPORT-EKSPORT  
DOOEL SHKUP”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 97, pika 6 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pikat 3 dhe 6, si dhe nenit 5, pika 1, gërmat “d” dhe “e” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1433/12 prot., datë 23.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi përfundimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL Shkup–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, dhënë nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për subjektin “SOLE 24 IMPORT-EKSPORT DOOEL SHKUP”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimet nr. 182, datë 29.05.2023 dhe nr. 183, datë 29.05.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1433/4 prot., datë 05.06.2023, SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për njohjen e licencës për veprimtarinë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, të lëshuar nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke argumentuar se në mungesë

të informacionit mbi mundësinë e njohjes së licencës sipas Rregullores për licencimin, ka dërguar fillimisht në ERE kërkesën përkatëse për marrjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Për këtë qëllim shoqëria ka depozituar në ERE licencën për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike, të lëshuar nga Komiteti Rregullator i Republikës së Maqedonisë së Veriut për Energjinë dhe Ujin (ERC) me nr. 12-423/22 prot., datë 07.11.2022.
- Në vijim, me shkresën nr. 1433/6 prot., datë 15.06.2023, ERE ka kërkuar nga shoqëria sqarim të objektit të saj, duke i sjellë në vëmendje se në zbatim të përcaktimeve të nenit 5, pika 1, gërma “d”, të Rregullores së licencimit, ERE nuk mund të japë një licencë për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat më të madh se 5 vjet, edhe njohja e kësaj licence do të bëhet për këtë afat, si dhe diferenca e pagesës së kryer për licencim do të mbahet në konsideratë në aplikimin e pagesës përkatëse rregullatore të vitit 2024 e në vijim.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 133/7 prot., datë 19.06.2023, shoqëria ka depozituar në ERE kthimin e përgjigjes së Komisionit Rregullator të Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, dërguar shoqërisë me e-mailin e datës 16.06.2023, ku bëhet me dije se referuar përcaktimeve të shtojcës 1, pika 8 e licencës, *Furnizimi me energji elektrike në kuptimin e kësaj licence konsiderohet blerja e energjisë elektrike nga vendi dhe nga jashtë, me qëllim shitjen tek konsumatorët, tregtarët, furnizuesit e tjerë, operatorit të transmetimit të energjisë elektrike, ose operatorët e sistemeve të shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe për pjesëmarrësit e tjerë në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me nenin 100 të Ligjit të Energjisë."*
- Për sa përcaktuar në licencë dhe për sa konfirmuar nga autoriteti rregullator i Maqedonisë së Veriut, vlerësohet se kjo licencë vlen për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit dhe asaj të tregtimit të energjisë elektrike.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1433/9 prot., datë 21.06.2023, shoqëria ka saktësuar se kërkon anulimin e procedurave të nisura për licencimin e saj në veprimtarinë e furnizimit dhe atë të tregtimit të energjisë elektrike dhe vijimin e procedurave për njohjen e licencës për furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike.
- Në vijim të saktësimit si më sipër, me e-mailin e protokolluar me nr. 1433/10 prot., datë 21.06.2023, ERE kërkoi informacion nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me vlefshmërinë e licencës së paraqitur për njohje dhe në rast se ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1433/11 prot., datë 22.06.2023, autoriteti rregullator i Maqedonisë së Veriut, ka njoftuar se kjo licencë është e vlefshme se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë veprim apo vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Shoqëria “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 4, pika 3 dhe Shtojcës 1/K të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Afati i vlefshmërisë së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 12-423/22, datë 07.11.2022, nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut është deri më 07.11.2032. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 5, pika 1, gërmat “d” dhe “e” të Rregullores së licencimit, ERE nuk mund të japë një licencë për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat më të madh se 5 vjet. Si rrjedhojë, edhe njohja e kësaj licence, e cila vlen për të ushtruar veprimtarinë e furnizimit dhe veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, do të bëhet për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga hyrja në fuqi e vendimit për miratimin e njohjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë njohjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin nr. 12-423/22, datë 07.11.2022, nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shoqërinë “SOLE 24 import-export DOOEL Shkup”, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj.
2. Me njohjen e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimit dhe, siç përcaktuar në këtë licencë, shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e furnizimit dhe atë të tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**